



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

**Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale Barazisë Gjinore Mosdiskriminimit
dhe të Drejtave të Njeriut**

Nr. 2



Fushë-Arrëz, më 24. 01. 2025

PËR : KËSHILLIN E BASHKISË

FUSHË-ARRËZ

Lënda: Relacion për projekt/vendimin “Miratimi i Kritereve për dhënien e Ndhmës Ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit për vitin 2025”, që do t’i paraqitet Këshillit të Bashkisë për shqyrtim në mbledhjen e tij të datës 27.01.2025.

Ne zbatim të ligjit 139/2015 “Per vetëqerisjen vendore”, i ndryshuar, Rregullores për Funksionimin e Këshillit të Bashkisë, Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale, në mbledhjen e datës 24.01.2025 me pjesëmarrjen e anëtareve: Tereze Dema, Franc Doda dhe Pavlin Qafa, mori në shqyrtim projektin e miratimit të Kritereve për dhënien e Ndhmës Ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit për vitin 2025, paraqitur nga Sektori i Shërbimit Social.

Anëtarët e Komisionit janë njohur me projektin përmes materialit shkresor, nderkohe në mbledhjen e komisionit, shpjegimet i dha Drejtoresha e Emigracionit e Çeshtjeve Sociale, zj.Sidorela Katroshi, e cila shpjegoi se kriteret për dhënien e Ndhmës Ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit për vitin 2025 nuk kane ndryshuar nga ato të vitit të mëparshëm.

Franc Doda anëtar i komisionit, jemi dakord me kriteret për dhënien e Ndhmës Ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit për vitin 2025, nese do te jete nevoja për ndonje ndryshim në këtë jemi, argumentojmë në bazë edhe të verifikimeve në terren dhe bëjmë ndryshimet e duhura.

Franc Doda anëtar i komisionit, thote se duhet të kontrollohen individët ku jetojnë dhe si i kanë kushtet në mënyrë që të trajtohen ato familje që janë në nevojë dhe që plotësojnë kriteret e përfitimit.

Anëtarët e komisionit kërkojnë që të gjithë specialistët e Njësive Administrative të jenë të pranishëm në mbledhjet e Komisioneve dhe atë Plenare.

Kriteret për përfitimin e masës së ndihmës ekonomike prej 6%:

Të përfitojnë nga këto kritere:

1. Të gjitha familjet të cilat nuk rezultojnë përfituese në skemen e Ndihmës Ekonomike për pikë të pamjaftueshme.
2. Familje me kryefamiljare femra në vështirësi ekonomike dhe sociale.
3. Familje me shumë fëmijë.
4. Familje me fëmijë jetimë.
5. Familjet me kushte të vështira ekonomike që në përbërjen e tyre kanë dy ose më shumë fëmijë që vazhdojnë studimet jashtë vendbanimit.
6. Familje me kushte të vështira ekonomike që në përbërjen e tyre kanë antarë të paaftë.
7. Familjet me kryefamiljare të veja apo të divorcuara.
8. Familje me dy ose më shumë antarë me vështirësi për t'u pranuar në tregun e punës.
9. Familje të cilat nuk kanë asnjë të punësuar.
10. Shtohet kriteri për familjet me antarë me sëmundje kronike.
11. Shtohet kriteri që familjeve një herë në tre muaj t'u bëhen riaplikim në skemën e NE.


Pas diskutimit anëtarët e komisionit, me shumicë votash, ranë dakort me projektin për Kriteret dhënies së Ndihmës Ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit për vitin 2025 të paraqitur dhe kërkuar miratimin e tij nga Këshilli Bashkiak në mbledhjen plenare të datës 27.01.2025 duke kërkuar edhe mendime dhe propozime të tjera të këshilltarëve të pranishëm.

Duke kërkuar bashkëpunimin tuaj!

Franc Doda



Pavlin Qafa



Tereze Dema

